

10-vjetori i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

12 mars 2018

Është një kënaqësi e madhe për mua të ndodhet sot këtu, për të festuar së bashku 10-vjetorin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në këtë epokë të teknologjisë digjitale dhe të rritjes eksponenciale të sasive të të dhënave, roli juaj si një mekanizëm mbikëqyrës nuk ka qenë kurrë më i rëndësishëm.

E drejta për informim është me rëndësi thelbësore për demokracinë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Qarkullimi i lirë i informacionit promovon llogaridhënien dhe transparencën, parandalon korrupsionin dhe forcon kapacitetin e grupeve të komunitetit dhe organizatave të shoqërisë civile për të marrë pjesë në vendimmarrje. Kjo është thelbësore, jo vetëm për të përcaktuar politikatat, por edhe për të kontrolluar qeverinë mbi mënyrën si i vë në zbatim këto politika.

Në të njëjtën kohë, privatësia është më e kërcënuar se kurrë.

Nuk mjafton që agjencitë të pretendojnë se ato e interpretojnë siç duhet ekuilibrimin e transparencës, privatësisë dhe interesit më të mirë publik, por ato duhet ta demonstrojnë atë publikisht dhe kjo do të thotë monitorim i fortë e i rreptë nga të tretët. Në këtë kontekst, jam i lumtur të shoh se Kuvendi, ministritë dhe institucionet e tjera të pavarura janë përfaqësuar në nivel të lartë sot këtu.

Ky është momenti juaj. Kemi qenë dëshmitarë të rritjes së mëtejshëm të Institucionit tuaj, duke marrë përsipër detyra dhe përgjegjësi dhe duke kontribuar gjithnjë e më shumë në rritjen e transparencës së autoriteteve publike, duke garantuar të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërsa ne vazhdojmë të digjitalizojmë çdo aspekt të jetës sonë dhe sasia e të dhënave tona vazhdon të rritet, roli juaj bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, si në rolin e mekanizmit mbikëqyrës, ashtu edhe në të mbështetjes së strukturave dhe politikave të internetit, të cilat promovojnë aksesin dhe privatësinë.

Këto janë thelbësore për mirëqeverisjen, për një demokraci funksionale dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, Prezenca e OSBE në Shqipëri është krenare që mbështet punën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ne do të bëjmë të mundur që një ekspert shqiptar të punojë së bashku me Zyrën e Komisionerit për të përgatitur amendimet e ligjit “Për të drejtën e informimit”; këtë vit do të organizojmë katër seminare mbi mbrojtjen e të dhënave, tre prej të cilave me zyrtarët publikë të bashkive dhe një në sektorin e shëndetit; do të vazhdojmë të lehtësojmë bashkëpunimin midis tre institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut.

Ne besojmë se Komisioneri duhet të vazhdojë të bëjë të dëgjohet dhe të këmbëngulë sa më fort dhe ne u bëjmë thirrje institucioneve dhe qytetarëve t’i kushtojnë vëmendje.

Gëzuar ditëlindjen!